



Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kuadër të zbatimit të projektit “ *Aftësi për Punësim të Qendrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punësim Shqipëri – Mal i Zi*”, njofton:

**THIRRJE PUBLIKE PËR TË GJITHË PUNËDHËNËSIT NGA SHQIPËRIA QË
OPEROJNË NË SEKTORIN E TURIZMIT DHE HOTELERISË, ICT DHE SEKTORË TË
TJERË TË NDËRLIDHUR**

PËR

**TRAJNIME NË VENDIN E PUNËS PËR TË RINJTË DHE GRATË ME SUPORTIN E NJË
MENTORI**

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Numri i punëdhënësve:	15 punëdhënës nga Shqipëria
Kohëzgjatja e trajnimit:	3 muaj
Financimi i programit:	- Një shumë maksimale prej 450.00 euro bruto në muaj për pjesëmarrësit në trajnim– me qëllim për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrësve. Shuma do t’u paguhet drejtpërdrejt pjesëmarrësve. - Kompensimi për mentorët në vendin e punës (punonjës në kompani) në shumën maksimale prej 200.00 euro bruto në muaj – me qëllim për të mbuluar shpenzimet e mentorit. Shuma do t’u paguhet drejtpërdrejt mentorëve.
Kushte të përgjithshme:	- Persona juridikë të regjistruar në: Bashkia Shkodër, Bashkia e Vaut të Dejës dhe Bashkia Malësi e Madhe. Punëdhënës nga vende të tjera që i përkasin zonës së programit të bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi mund të merren në konsideratë.



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

	<p>Dokument që duhet bashkëngjitur: Çertifikata e regjistrimit të biznesit.</p> <p>-Persona juridikë të regjistruar që operojnë në sektorin e turizmit, hotelerisë, ICT dhe sektorë të tjerë të ndërlidhur.</p> <p>Dokument që duhet bashkëngjitur: Ekstrakt i biznesit nga QKB.</p>
--	--

2. SI TË APLIKONI

Punëdhënësit e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin së bashku me dokumentat e kërkuara në adresën e e-mail info@aida.gov.al **jo më vonë se 03/ 07/2023 deri në orën 16:30.**

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Formularin e aplikimit (formulari bashkëlidhur)
- Çertifikatë e regjistrimit të kompanisë (NIPT)
- Ekstrakti nga QKB
- Vërtetim nga drejtoria tatim taksave mbi pagesën e detyrimeve
- Deklarata e nënshkruar e aplikantit (Deklarata bashkëlidhur)
- Formulari i aplikimit për mentor (formulari bashkëlidhur)
- Vërtetim punësimi nga punëdhënësi – si provë që mentori është punonjës i kompanisë që po apikon.

Më shumë informacion mbi këtë thirrje të hapur është paraqitur në Dokumentin e Termave të Referencës.

Punëdhënësit që dëshirojnë të aplikojnë në këtë thirrje duhet të shkarkojnë: Termet e Referencës për Trajnimin në vendin e punës, programin e mentorimit dhe formularin e aplikimit nga faqet web. [AIDA](#) dhe [Link](#)



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Tiranë, 19.06.2023.

TERMAT E REFERENËS NË LIDHJE ME TRAJNIMET NË VENDIN E PUNËS DHE PROGRAMIN E MENTORIMIT

1. MBI PROJEKTIN

Projekti: “Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi - Aftësi për Punë Shqipëri – Mali i Zi”

Grupi(et) e synuar: Punëkërkuarit me nivel të ulët dhe të mesëm arsimimi, nivel të ulët kualifikimi dhe me aftësi që nuk përputhen me kërkesën e tregut të punës, të rinjtë (mosha 15 deri në 29 vjeç) dhe gratë në zonën e ndërkufitare që kërkojnë punësim; Pronarët/punëdhënësit e bizneseve nga zona ndërkufitare që forcohen përmes programit mbështetës për konkurrencën dhe nxitjen e punësimit.

Përfituesit përfundimtarë: Të rinjtë, gratë, familjet dhe pronarët/punëdhënësit e bizneseve në zonën ndërkufitare që përfitojnë nga rritja e fuqisë punëtore të kualifikuar; komunat dhe komunitetet rurale në zonën ndërkufitare; palët e interesuara institucionale dhe shoqëria e përgjithshme në zonën ndërkufitare.

Projekti parashikon mbështetje për zhvillimin e aftësive sipërmarrëse dhe punësimin e të rinjve (15-29 vjeç) si dhe grave si grupet kryesore të synuara, si dhe ofrimin e mbështetjes së qëndrueshme për punëdhënësit në zonën ndërkufitare.

Mbështetja ofrohet në sektorët prioritarë të zhvillimit në zonën ndërkufitare: turizëm, hoteleri, TIK, bujqësi dhe sektorë të ndërlidhur.

Në konsultim me punëdhënësit dhe palët e tjera të interesuara, kontributi për qëllimin do të arrihet përmes:

- Rritjes së aftësive dhe kompetencave profesionale të të rinjve dhe grave të papuna për të plotësuar nevojat për punësim në sektorët e turizmit, hotelierisë dhe ICT-së;
- Zhvillimit të aftësive të vetëpunësimit/sipërmarrjes – planifikimi strategjik, rrjetëzimi, marketingu dhe shitjet, e-biznesi – në fushën e ICT-së, turizmit, hotelierisë, gastronomisë dhe artizanatit;



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

- Krijimit të markës ndërkufitare për të promovuar produktet dhe shërbimet lokale. Një nga aktivitetet e projektit është zbatimi i një programi trajnimi në vendin e punës për personat e papunë.

2. NË LIDHJE ME TRAJNIMET NË VENDIN E PUNËS DHE PROGRAMIN E MENTORIMIT

Trajnimi në vendin e punës nënkupton një mundësi afatshkurtër për të papunët dhe të gjithë individët e tjerë në zonën ndërkufitare për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale, për të fituar përvojë pune dhe për të kuptuar më mirë detyrat e një vendi të caktuar pune.

Nëpërmjet projektit, mundësia e trajnimit në vendin e punës do t'u ofrohet gjithsej 15 personave të papunë në Shqipëri.

Një pjesëmarrës në trajnimin në vendin e punës është një individ i papunë dhe çdo individ tjetër me arsim të ulët dhe të mesëm, nivel të ulët kualifikimi dhe me aftësi që nuk korrespondojnë me kërkesën në tregun e punës: të rinjtë (nga mosha 15 deri 29) dhe gratë në zonën ndërkufitare të cilat kërkojnë punë.

Përparësi do të kenë personat deri në 29 vjeç. Është e nevojshme të lidhet një kontratë shërbimi me pjesëmarrësin në trajnim.

Trajnimi në vendin e punës kryhet nëpërmjet një pune të përcaktuar qartë ndërmjet personit të papunë dhe punëdhënësit. Trajnimi do të zgjasë 3 muaj dhe në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësi në trajnim do të pajiset me çertifikatë për përvojën e fituar në punë.

Detyrat kryesore të mentorit janë: të njohë pjesëmarrësit në trajnim me politikat, rregullat dhe procedurat e punës së punëdhënësit, të angazhojë pjesëmarrësit në trajnim në detyra specifike pune, të monitorojë ekzekutimin e detyrave specifike të punës, të këshillojë pjesëmarrësit në trajnim sipas nevojës, të informojë punëdhënësit për detyrat e kryera dhe cilësinë e detyrave të kryera, të kontaktojë rregullisht me menaxherin e projektit i cili është përgjegjës për trajnimet dhe programin e mentorimit, si dhe të shkruajë një raport përfundimtar për ecurinë e pjesëmarrjes në trajnim të të gjithë individëve që e përfundojnë me sukses trajnimin.

Projekti parashikon organizimin e një seminari një-ditor për punëdhënësit dhe pjesëmarrësit e trajnimit në vendin e punës me qëllim njohjen e tyre me të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrjes në program, të cilat do të theksohen në kontratat e shërbimit të cilat do të nënshkrohen me pjesëmarrësit në trajnim.



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Pas seminarit prezantues, punëdhënësve do t'u shpërndahen Udhëzimet për zbatimin e trajnimit në vendin e punës, të cilat gjithashtu do të postohen në kohën e duhur dhe do të vihen në dispozicion përmes faqeve të internetit të partnerëve të projektit.

3. OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E TRAJNIMEVE NË VENDIN E PUNËS DHE TË PROGRAMIT TË MENTORIMIT

Qëllimi kryesor është mbështetja e procesit të punësimit duke u dhënë mundësinë të papunëve dhe të gjithë personave të tjerë të fitojnë përvojë pune dhe të zhvillojnë aftësi profesionale.

Rezultatet e pritshme të thirrjes publike:

- a) Të paktën 30 punëdhënës nga zona e programit aplikojnë për të ofruar trajnime në vendin e punës.
- b) Të paktën 15 persona të angazhuar si pjesëmarrës në trajnimin në punë.
- c) Së paku 15 persona të angazhuar si mentorë (trajnuar) me qëllim që të mbështesin pjesëmarrësit në trajnimin në punë.

4. APLIKANTËT E PRANUAR

Për këtë thirrje mund të aplikojnë punëdhënës nga fusha e turizmit dhe hotelerisë, gastronomisë, ICT-së, artizanatit tradicional dhe sektorëve të ndërlidhur nga Shqipëria të cilët janë të regjistruar si subjekte ekonomike në Bashkinë Shkodër, Bashkinë e Vaut të Dejës dhe Bashkinë e Malësisë së Madhe.

Punëdhënësit nga vende të tjera që i përkasin zonës së Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar gjithashtu do të merren parasysh.

Konflikti i interesit: Subjektet që janë në konflikt të mundshëm interesi, pra që mund të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes objektive në çfarëdo mënyre, nuk mund të aplikojnë për këtë thirrje.

Stafi i projektit rezervon të drejtën të refuzojë një aplikim që konstatohet se është në një konflikt të mundshëm interesi në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe rregullat e Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

5. FONDET E DISPONUESHME

Për realizimin e projektit të trajnimit në vendin e punës sigurohen fonde në shumën totale prej 20,200.00€, pra maksimumi 450.00€ në muaj për pjesëmarrësit për kompensim bruto të të gjitha shpenzimeve të angazhimit në punë.

Fondet në vlerë prej 9,000.00€, ose 200.00€ bruto në muaj për mentor, janë siguruar për zbatimin e programit të mbështetjes së mentorimit për pjesëmarrësit në trajnim.

6. KOSTOT E LEJUARA

Fondet nga kjo thirrje mund të përdoren vetëm për të financuar kostot e mëposhtme:

- a) Kompensimi bruto për pjesëmarrësit e trajnimit në punë bazuar në kontratën e shërbimit të nënshkruar me pjesëmarrësin në trajnim.
- b) Tarifa bruto për mbështetjen e mentorimit bazuar në kontratën e shërbimit të nënshkruar me mentorin.

7. AFATI I THIRRJES PUBLIKE

Thirrja publike është e hapur deri më **3 korrik 2023**. Të gjitha aplikacionet e dërguara më vonë nuk do të konsiderohen.

Përzgjedhja e aplikantëve që do të bashkëfinancohen për trajnimet në vendin e punës përmes kësaj thirrjeje publike do të bëhet deri në fund të korrikut 2023.

Afati për nënshkrimin e Kontratës është 15 ditë pas dorëzimit të informacionit për përzgjedhjen.



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

8. AFATI DHE SI TË APLIKONI

Aplikantët duhet të dërgojnë dokumentacionin në adresën e mëposhtme të e-mailit: info@aida.gov.al jo më vonë se data **03 korrik 2023, deri në orën 16:30**.

Aplikimi duhet të përmbajë:

- a) Formularin i aplikimit (formulari i bashkëlidhur)
- b) Çertifikatë e regjistrimit të kompanisë (NIPT)
- c) Ekstrakti nga QKB
- d) Vërtetim nga drejtoria tatim taksave mbi pagesën e detyrimeve
- e) Deklarata e nënshkruar e aplikantit (deklarata bashkëlidhur)
- f) Formulari i aplikimit për mentor (formulari bashkëlidhur)
- g) Vërtetim punësimi nga punëdhënësi – si provë që mentori është punonjës i kompanisë që po aplikon.

9. KRITERET DHE MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË APLIKANTËVE

Përzgjedhja e punëdhënësve: Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Stafi i Projektit në emër të Kontraktorit.

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- dëshmi e aftësisë financiare dhe operacionale të aplikantit për të punësuar pjesëmarrës për trajnime në punë;
- mundësia e punësimit të pjesëmarrësve në baza të përhershme pas përfundimit të trajnimit në vend të punës;
- gatishmëria për të bashkë-financuar kostot e trajnimit të pjesëmarrësve në punë.

Vendimi për përzgjedhjen e aplikantëve do t'u dërgohet të gjitha subjekteve që aplikojnë në këtë thirrje.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve të trajnimit në vendin e punës: Përzgjedhja bëhet nga punëdhënësi bazuar në përshkrimin e punës, profilin e pjesëmarrësit të mundshëm dhe kriteret e Projektit.

Kriteret bazë janë përcaktuar në kapitullin 2 të këtij dokumenti. Punëdhënësi mund të sugjerojë personalisht profilin dhe/ose emrin dhe mbiemrin e personit që planifikon të punësojë si pjesëmarrës në trajnim nëpërmjet aplikimit në thirrjen publike.



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Në këtë rast, stafi i projektit do të përcaktojë nëse personi i përmendur i plotëson kriteret bazë për trajnim në punë.

11. MONITORIMI I TRAJNIMIT NË VENDIN E PUNËS

Monitorimi është gjithashtu një mjet për këshillimin dhe mbështetjen e pjesëmarrësve të trajnimit në vendin e punës dhe ndërmarrjes ku do të trajnohet.

Monitorimi përfshin komunikim të rregullt me pjesëmarrësin dhe menaxherin e ndërmarrjes për zbatimin e trajnimit në vendin e punës, i cili kryhet nga koordinatori i projektit.

Monitorimi përfshin një vizitë tek pjesëmarrësi i trajnimit në punë, një rishikim i dokumentacionit (Kontrata, lista e pagave, të dhënat e fletëve të orarit dhe detyrave të punës, etj.).

Kontaktet me pjesëmarrësit e trajnimit në punë bëhen të paktën një herë në muaj dhe më shpesh nëse është e nevojshme.

12. KONTAKT

Për më shumë informacion, mund të kontaktoni:

Email: info@aida.gov.al

Telefon: + 355 (042) 251 001



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

PROGRAMI PËR TRAJNIMIN NË VENDIN E PUNËS

FORMULARI I APLIKIMIT

Afati për të dorëzuar aplikimin është data **03 Korrik 2023, ora 16:30**

1.	Emri i ndërmarrjes	
2.	Bashkia ku jeni të regjistruar	
3.1.	Adresa	
3.2.	E-mail	
3.3.	Nr. Telefoni	



Funded by
the European Union





4.	Përshkrimi i aktiviteteve të subjektit (shkurtimisht)	
5.	Përshkrimi i punës për pjesëmarrësit e duhur në trajnim	
5.1	Kualifikimet e duhura për pjesëmarrësit në trajnim	
6.	Pas përfundimit të trajnimit, a ka mundësi për punësim të përhershëm?	PO JO
7.	A keni një kandidat për pjesëmarrje në trajnim?	PO JO
7.1	Emri, mbiemri dhe datëlindja e pjesëmarrësIt potencial në trajnim	
7.2	Kualifikimet e pjesëmarrësIt potencial në trajnim	
8	Lista e dokumenteve që dorëzoni është bashkëngjitur.	





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

(shembull: deklaratat e nënshkruar e aplikantit, konfirmimi i punëdhënësit për punonjësin, etj.)	
--	--

Vendi dhe data e aplikimit:

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës:

DEKLARATA E APLIKUESIT PËR PROGRAMIN E TRAJNIMIT NË VENDIN E PUNËS LIDHUR ME PROJEKTIN

“Aftësi për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi - Aftësi për Punë Shqipëri – Mali i Zi”

Unë, i nënshkruari (emri dhe mbiemri)

në cilësinë e (funksioni)

nën përgjegjësinë e plotë materiale dhe penale, konfirmoj se informacioni i deklaruar në Formularin e Aplikimit për trajnimin në vendin e punës është i saktë dhe se jam njohur dhe i pranoj të gjitha kushtet e përcaktuara në Termat e Referencës për trajnimin dhe mentorimin gjatë punës së projektit “Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi - Aftësi për Punë Shqipëri – Mali i Zi”.

Së bashku me aplikimin paraqes (specifikoni dokumentet e bashkëlidhura):

- Formulari i aplikimit për programin e trajnimit në punë (formulari i bashkëlidhur)
- Formulari i aplikimit për një mentor

Emri dhe Mbiemri:



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Firma:

Vula

Formulari i Aplikimit për një Mentor

Emri, Mbiemri	
Nr. Telefonit	
Numri ID	
Lloji dhe niveli i edukimit formal	
Vendi i punës dhe pozicioni në kompani	
Një përshkrim i shkurtër i pozicionit të cilit mbuloni	
Eksperiencia pune dhe aftësi	

Vendi dhe data:

Emri dhe Mbiemri:

Firma:



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Funded by
the European Union

